

KOMPANIA RAJONALE PËR UJËSJELLËS “HIDROMORAVA”- SH.A.

**RAPORTI I PUNËS
PËR TREMUJORIN E DYTË TË VITIT 2024**

Korrik, 2024

TABELA E PËRMBAJTJES

1. KRYESHEFI EKZEKUTIV	5
1.1. Hyrje.....	5
1.2. Aktivitetet kryesore.....	5
1.3. Vendime dhe akte të tjera	8
2. BORDI I DREJTORËVE	10
2.1. Vendimet e Bordit të Drejtorëve.....	11
3. KOMISIONI I AUDITIMIT	11
3.1. Vendimet e Komisionit të Auditimit	12
4. ZYRA E SEKRETARIT	13
4.1. Struktura e të punësuarve.....	13
4.2. Çështjet gjyqësore.....	13
5. ZYRTARJA E LARTË FINANCIARE	17
5.1. Aktivitetet kryesore.....	17
5.2. Shqyrtimi i performances operative dhe financiare	17
5.3. Draft pasqyrat financiare	28
6. RAPORT I ZYRËS SË PROKURIMIT	44
7. RAPORTI PËR CILËSI TË UJIT PËR TM2– 2024	45
7.1. Cilësia e ujit.....	46
8. DIVIZIONI PËR PRODHIMIN, IMPIANTET E UJIT DHE STACIONET E POMPIMIT	25
8.1. Furnizimi me ujë.....	47
8.2. Sasia e ujit të prodhuar, ujit të faturuar dhe humbjeve të ujit.....	25
8.3. Mirëmbajta e rrjetit të ujësjellësit	50
8.4. Mirëmbajta e rrjetit të kanalizimit	55

TABELAT

Tabela 1. Takimet e Kryeshefit Ekzekutiv me institucionet dhe organizatat relevante gjatë periudhës TM2/2024	5
Tabela 2. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës TM2/2024	8
Tabela 3. Numri i të punësuarve në njësitë punuese për periudhën TM2/2024	13
Tabela 4. Struktura gjinore e të punësuarve për periudhën TM2/2024	13
Tabela 5. Lëndët e pranuar nga Gjykatat kompetente gjatë periudhës TM2/2024	14
Tabela 6. Paraqitja grafike e prodhimit të ujit në m ³	17
Tabela 7. Paraqitja grafike e faturimit të ujit në m ³	17
Tabela 8. Paraqitja grafike e faturimit në euro (€)	18
Tabela 9. Paraqitja grafike e arkëtimit të ujit	18
Tabela 10. Paraqitja grafike e përqindjes së arkëtimit	19
Tabela 11. Paraqitja grafike e shpenzimeve në €	20
Tabela 12. Raporti i performancës operative dhe financiare për regjion TM2/2024 dhe TM2/2023 dhe plani TM2/2024	21
Tabela 13. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësine Operative të Gjilanit TM2/2024 dhe krahasimi me TM2/2023	23
Tabela 14. Raporti i performancës operative dhe financiar për Njësine Operative të Kamenicës TM2/2024 dhe krahasimi me TM2 /2023	24
Tabela 15. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësine Operative në Vitisë për TM2/2024, krahasimi me TM2/2023	25
Tabela 16. Treguesit – të hyrat dhe shpenzimet operative për TM2/2024 dhe krahasimi me TM2/2023	26
Tabela 17. Paraja dhe ekuivalentet e parashë përfshijnë paranë në banka dhe në arkë	37
Tabela 18. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera	37
Tabela 19. Stoqet	38
Tabela 20. Pasuritë tjera afatshkurta	38
Tabela 21. Pronat, impiantet dhe pajisjet	38
Tabela 22. Llogaritë e pagueshme	40
Tabela 23. Detyrimet tjera afatshkurtra	40
Tabela 24. Të hyrat e shtyra /grantet	41
Tabela 25. Ekuiteti	41
Tabela 26. Të hyrat	41
Tabela 27. Shpenzimet e shpërndarjes	42
Tabela 28. Shpenzime administrative të tjera	42
Tabela 29. Fitimi (humbja) para tatimit	42
Tabela 30. Ndryshimet në ekuitet	43
Tabela 31. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM2/2024 – vlerë minimale	44
Tabela 32. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë TM2/2024 – kuotim i çmimit	44
Tabela 33. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM2/2024 – procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	44
Tabela 34. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM2/2024 – procedurë e hapur – vlerë e mesme	45
Tabela 35. Aktivitetet e prokurimit gjatë TM2/2024 – procedurë e hapur – vlerë e madhe	45

Tabela 36. Sasia e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar gjatë periudhës së TM2/2024	48
Tabela 37. Sasisa e ujit të prodhuar, faturuar dhe ujit të pafaturuar për TM2/2024 krahasuar me raportin e TM2/2023	49
Tabela 38. Zona e shërbimit, numri dhe natyra e defekteve të ndodhura gjatë periudhës së TM2/2024... 50	
Tabela 39. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPP, gjatë periudhës së TM2/2024 në DMA zonat për regjionin e Gjilanit	53
Tabela 40. Numri i intervenimeve në rrjetin e kanalizimit gjatë periudhës së TM2/2024.....	55
Tabela 41. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit gjatë periudhës së TM2/2024 në Gjilan	55

SHËNIMET SHPJEGUESE

Shënimet shpjeguese 1. Paraja dhe ekuivalentet e parasë.....	37
Shënimet shpjeguese 2. Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat tjera.....	37
Shënimet shpjeguese 3. Stoqet.....	37
Shënimet shpjeguese 4. Pasuritë tjera afatshkurta	38
Shënimet shpjeguese 5. Pasuritë afatgjata – pronat, impiantet dhe pajisjet	38
Shënimet shpjeguese 6. Investimet në vijim/projektet.....	39
Shënimet shpjeguese 7. Llogaritë e pagueshme për TM2 2024	39
Shënimet shpjeguese 8. Detyrimet tjera afatshkrutë.....	40
Shënimet shpjeguese 9. Të hyrat e shtyera/grantet	41
Shënimet shpjeguese 10. Ndryshimi në ekuitet	41
Shënimet shpjeguese 11. Të hyrat.....	41
Shënimet shpjeguese 12. Shpenzimet e shpërndarjes.....	42
Shënimet shpjeguese 13. Shpenzimet administrative të tjera.....	42
Shënimet shpjeguese 14. Fitimi (humbja) para tatimit e vitit	42

1. KRYESHEFI EKZEKUTIV

1.1. Hyrje

Raporti i përket periudhës raportuese të tremujorit të dytë të vitit 2024 dhe ndërlidhet me performancën aktuale financiare dhe operative, përshkrimin e arritjeve të caqeve të planit të biznesit të KRU “Hidromorava” – SH.A. Gjilan.

Gjatë kësaj periudhe raportuese menaxhmenti i Ndërmarrjes është fokusuar në një mbikëqyrje më të madhe në të gjithë sektorët punues, konform aktiviteteve të ushtruara si në: leximin e rregullt të ujëmatësve, efikasitetin e shtuar në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, sigurimin dhe montimin e ujëmatësve për konsumatorët me paushall, në detektimin e rrjedhjeve, vendosjen e bllokuesve në ujëmatës të konsumatorët që kanë borxhe ndaj Kompanisë etj.

Gjithashtu, sfidë për Ndërmarrjen ende mbeten: inkasimi i borxheve të vjetra, zvogëlimi i humbjeve të ujit përmes identifikimit të kyçjeve ilegale si dhe atyre teknike, evitimi i rrjedhjeve të ujit në kohë sa më të shkurtë etj, për të cilat aktivitete është duke u punuar sipas “Planit të Veprimit për vitin 2024”.

1.2. Aktivitetet kryesore

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, krahas angazhimeve të përditshme në menaxhim të Ndërmarrjes, Kryeshefi Ekzekutiv ka mbajtur edhe takimet e listuara në tabelën më poshtë:

Tabela 1. Takimet e Kryeshefit Ekzekutiv me institucionet dhe organizatat relevante gjatë periudhës TM2/2024

Nr.	Institucioni:	Data:	Qëllimi i takimit:
1.	Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregeti në Kuvendin e Kosovës.	03.04.2024	Së bashku me Kryesuesen e Bordit, pjesëmarrje në seancën dëgjimore, lidhur me sfidat në zbatim të legjislacionit nga institucionet ligj-zbatuese dhe ndërmarrjet publike në sektorin e shërbimeve të ujit. Se bashku me Kryesuesën e Bordit kemi raportuar për të arriturat e Ndërmarrjes për vitin 2023.
2.	Rrjeti i zhvillimit të kapaciteteve rajonale për shërbimet e ujit dhe kanalizimit – RCDN.	15.04.2024 deri 17.04.2024	Trajnim për avokim dhe lobim, i cili ka pasur për qëllim të forcoj kapacitetet e shoqatave partnere se si të ndikojnë në politikat publike, përmes fushatave avokuese, lobimit legjislativ dhe ndërtimit të bashkëpunimit.
3.	Kryetarin e Komunës së Klllokotit.	18.04.2024	Diskutim rreth projektit të ujësjellësit për Komunën e Klllokotit si dhe lidhja e marrëveshjes së bashkëpunimit me këtë komunë.

4.	Drejtorin e Drejtorisë së SHPIB – Komuna e Vitisë.	18.04.2024	Në këtë takim kemi diskutuar për thellimin e bashkëpunimit, si dhe investimet që Komuna e Vitisë duhet ti bëjë në disa fshatra të kësaj komune, në mënyrë që të jenë të gatshme për pranim teknik dhe pastaj të merren nën menaxhim nga KRU “Hidromorava”.
5.	EBRD.	22.04.2024	Së bashku me Menaxherin e Kontratës së FTUZ, takim pune në EBRD. Gjatë këtij takimi kemi diskutuar në lidhje me fazat në të cilat ndodhet FTUZ si dhe problemet që mund të dalin nga shpronsimi i trasesë nëpër të cilën do kalojnë kolektorët.
6.	Takimi i rregullt vjetor i Bordeve SHUKOS dhe SHUKALB në Vlorë.	25.04.2024	Si pikë kryesore e këtij takimi ka qenë Raporti mbi Konferencën dhe Ekspozitën e vitit 2023 të mbajtur në Durrës si dhe Planifikimi i Konferencës dhe Ekspozitës së përbashkët Ballkanike në vitin 2024 që do të organizohet në Prishtinë.
7.	Këshilli Ndërmintor i Ujrave – z.Afrim Lajçi dhe z. Baton Begolli.	29.04.2024	Në këtë takim, këshilltarët kanë përmbledhur gjendjen fillestare, arritjet kryesore dhe sfidat që mbeten të trajtohen në vijim. Me këtë rast, ministrat anëtarë të Këshillit pritet të paraqesin reformat e planifikuara/ndërmarra për zhvillimin e sektorit.
8.	Ministria e Ekonomisë	03.05.2024	Diskutim në lidhje me fazën në të cilën ndodhet projekti i ITUN si dhe mjetet buxhetore, të cilat mund të shpenzohen gjatë vitit 2024.
9.	SHUKOS	08.05.2024	Takimi i rregullt i Bordit të SHUKOS, ku një ndër pikat për diskutim ishte edhe zarfimi i faturave të konsumatorve. Në takim ishte e ftuar edhe Kryeshefja Ekzekutive e PTK-së me që rast u dakordua që të gjitha KRU-ve të ju ofrohet një çmim i pranueshëm për zarfim të faturave.
10.	FOPIP dhe NEXIA	13.05.2024	Nënshkrimi i Marrëveshjes për “Vlerësim të Aseteve” ndërmjet KRU “Hidromorava” dhe NEXIA, me bashkëfinancim të SECO dhe KRU “Hidromorava”, me procedura të udhëhequra nga FOPIP.
11.	Ministria e Ekonomisë	14.05.2024	Mbledhja e rregullt vjetore me Aksioarin, ku është diskutuar për performancën e Ndërmarrjes gjatë vitit 2023.
12.	EBRD	22.05.2024	Gjatë këtij takimi kemi raportuar në lidhje me progresin e arritur në projektin e ITUN si dhe vështësitë në të cilat po hasë projekti përshkak të

			shpronësimit/servitutit ku do të kalojnë kolektorët e ujërave të ndotura.
13.	EBRD dhe Kryetari i Komunës Gjilan	24.05.2024	Diskutim në lidhje me shpronësimet dhe servitutet në Komunën e Gjilanit dhe Parteshit, me ç'rast është kërkuar nga Kryetari i Komunës së Gjilanit, zotimi se në buxhetin e Komunës për vitin 2025 do të parashihen edhe shpronësimet dhe servitutet për Komunën e Gjilanit dhe Parteshit, gjë të cilën Kryetari i Komunës së Gjilanit e ka pranuar dhe pas takimit është dërguar zotimi në EBRD.
14.	Kryetari i Komunës Gjilan	30.05.2024	Gjatë këtij takimi janë nënshkruar dy marrëveshje ndërmjet KRU "Hidromorava" dhe Komunës së Gjilanit. Është nënshkruar Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve, si dhe Marrëveshja për "Ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Cërnice".
15.	Komuna Gjilan	04.06.2024	Takim me Kryetarin e Komunës Gjilan, ku si temë diskutimi ishin mbarëvajtja e proceseve të projekteve të financuara nga ME, Komuna Gjilan dhe KRU "Hidromorava".
16.	Komuna Kamenicë	05.06.2024	Takim me Kryetarin e Komunës së Kamenicës, ku si temë diskutimi ishin mbarëvajtja e proceseve të projekteve të financuara nga ME, Komuna e Kamenicës dhe KRU "Hidromorava".
17.	ARRU	20.06.2024	Prezentimi i përgatitjes së procesit tarifor për vitin 2025 nga përfaqësuesit e ARRU, ku i është dhënë theks i veçantë investimeve në infrastrukturë nëntokësore të cilat ndikojnë më shumë në ngritje të tarifës.
18.	DSHP Gjilan	26.06.2024	Në takim është diskutuar vendosja e rrethojave ndërmjet parkut "BAJA" të ndërtuar nga Komuna Gjilan, dhe SP "BAJA", pasi që është obligim ligjor që burimet e ujit të jenë të rrethuara dhe jo të qasshme për personat e pa-autorizuar.
19.	FOPIP dhe NEXIA	27.06.2024	Temë diskutimi ka qenë bashkërendimi i aktiviteteve në terren, në mes të NEXIA, FOPIP dhe KRU "Hidromorava", në mënyrë që identifikimi dhe vlerësimi i aseteve të bëhet sa më mirë dhe më saktë.
20.	Komuna Viti	28.06.2024	Takim me Kryetarin e Komunës në Viti, ku si temë diskutimi ka qenë zgjerimi i zonës së shërbimit edhe në disa fshatra të Komunës Viti, me ç'rast e kemi njoftuar Kryetarin se KRU "Hidromorava" është e gatshme ti merr nën menaxhim të gjitha fshatrat që

		janë të gatshme për pranimit teknik të ujësjellësit. Gjithashtu, Sekretarja e Kompanisë, ka kërkuar nga Kryetari i komunës, që pronat e KRU “Hidromorava” në regjionin e Vitisë, të kalojnë në shfrytëzim të KRU “Hidromorava”.
--	--	---

1.3. Vendime dhe akte të tjera

Në kudër të detyrave dhe përgjegjësi të tij, Kryeshefi Ekzekutiv gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024 ka nxjerrë 19 vendime të listuara si më poshtë:

Tabela 2. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv gjatë periudhës TM2/2024

Nr.	Vendimi:	Numri i Vendimit:	Data e protokollimit:
1.	Vendim që punëtorëve të angazhuar në fabrikat për përpunimin e ujit në Përlepnice dhe Velekincë të mos u organizohet transporti me mjete të Kompanisë, por t'i kompenzohet një shumë prej 30.00€ për çdo muaj secilit.	357	02.04.2024
2.	Vendim për caktimin e kujdestarisë inaktive për ekipet në mirëmbajtjen e shërbimit në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit me kompenzim prej 35.00€ e cila vlerë do të kalkulohet në orët e punës në përputhje me dispozitën e nenit 56. paragrafi 2 nën paragrafi 2.1. të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 në Kosovë.	358	02.04.2024
3.	Vendim për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e procedurës së rekrutimit për pozitat punuese në njësinë operative në Viti, një /1/ operator në FPU” Letnicë, një /1/ lexues të ujëmatësve dhe një /1/ mjeshtër në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, sipas konkursit publik të shpallur me datë 26.03.2024.	424	18.04.2024
4.	Vendim për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për vendet e lira të punës në Njësinë Operative në Viti, për pozitat një /1/ operator në FPU” Letnicë, një /1/ lexues të ujëmatësve-inkasant, dhe një /1/ mjeshtër në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, sipas konkursit publik të shpallur më 26.03.2024.	425	18.04.2024
5.	Vendim për dhënien e ndihmës materiale në shumë prej: 150.00€, me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes	481 dhe	02.05.2024 dhe

	(babait) për të punësuarin Pëllumb Haliti dhe Bajram Lenjani, me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes (nënës) konform Rregullores për kompenzimin e udhëtimit zyrtar, gradimeve dhe ndihmave solidare.	640	30.05.2024
6.	Vendim për sistemimin e të punësuarëve si në vijim: Nezir Neziri: “Mjeshtër në rrjetin e ujësjellësit në Nj.O. – Viti”, Rrahman Hasimi: “Lexues i ujëmatësve në Nj.O. – Viti” dhe Xhelal Pira si “Operator në FPU në Nj.O. – Viti”.	515, 516 dhe 517	13.05.2024
7.	Vendim për formimin e grupit punues për Planin e sigurisë së ujit dhe menaxhimit të krizave.	540	16.05.2024
8.	Vendim për ndërprerjen e kontratës së punës sipas fuqisë ligjore – pensionimi, për të punësuarin Ibrahim Islami, i sistemuar në punët dhe detyrat punuese “Operator i punëtorisë së ujëmatësve në Nj.O. – Viti”.	606	23.05.2024
9.	Vendim për publikimin e konkursit publik për vende të lira të punës, një (1) vozitës të eskavatorit dhe një (1) punëtor fizik për mirëmbajtjen e rrejtit të kanalizimit në KRU “Hidromorava” Sh.A.	639	30.05.2024
10.	Vendim për sistemimin e të punësuarëve si në vijim: Rina Ahmeti: “Zyrtare në zyrën për konsumator në Divizionin e shërbimit me konsumator në KRU “Hidromorava” Sh.A.”, Flora Hoxha: “Zyrtare në qendrën e thirrjeve në Divizionin e shërbimit me konsumator në KRU “Hidromorava” Sh.A dhe Haxhere Mustafa: “Ndihmëse faturiste në Divizionin e faturimit në KRU “Hidromorava” Sh.A.”.	651,661 dhe 663.	03.06.2024 dhe 04.06.2024
11.	Vendim për caktimin e komisionit vlerësues për projektin e punimeve FLOWS-pako 1, në përbërje prej dy /2/ anëtarëve: z. Skender Ramadani dhe z. Nexhmedin Leka.	671	06.06.2024
12.	Vendim mbi pagesën e kompensimit për shfrytëzimin e ujërave nëntokësore për burimet “Baja”, “Guri i Hoxhës”, Liqeni - penda në fshatin Përlepnice, në Letnicë, pusët në Kamenicë dhe në fshatin Velekincë.	688	13.06.2024
13.	Konform nenit 67 pika 1.4, nenit 72 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212, dhe nenit 16. pika 8. të kontratës së punës nr. 259 të dt. 08.02.2023, të punësuarit Osman Musliu nga fshati Sadovinë e Jerlive, Komuna Viti, i sistemuar në punët dhe detyrat punuese depoist në Nj.O. në Viti, i	709	20.06.2024

	ndërpritet marrëdhënia e punës me dt. 28.06.2024, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit prej 65 vjet.		
14.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të aplikuesve për pozitat: Vozitës i Eskavatorit dhe Punëtor Fizik në mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit në KRU "Hidromorava" Sh.A. konform Konkursit Publik të shpallur me datë 04.06.2024.	723	21.06.2024

2. BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve të KRU "Hidromorava" gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024 ka mbajtur tri /3/ mbledhje të rregullta dhe Mbledhjen e Përgjithshme të Kuvendit të Aksionarit.

2.1. Vendimet e Bordit të Drejtorëve

Vendimmarrja në Bordin e Drejtorëve gjithmonë është bërë në mënyrë të lirë dhe demokratike duke e respektuar të drejtën e votimit të lirë, pa presion dhe vendosjes me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit.

Bordi i Drejtorëve në tremujorin e dytë të vitit 2024, bazuar në procesverbalet të dt. 30.04.2024, 29.05.2024, 25.06.2024 ka marrë këto vendime:

- Bordi i Drejtorëve, ka miratuar raportet për muajt: mars, prill dhe maj 2024;
- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur më: 30.04.2024 ka miratuar Planin e Veprimit për Zvogëlimin e UPF-së, Planin e Veprimit për Menaxhimin e Ujëmatësve dhe Planin e Veprimit Gjiner të propozuar nga Banka Botërore;
- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur më: 29.05.2024 ka miratuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Formularin për vetëvlerësimin e Bordit të Drejtorëve të KRU "Hidromorava" Sh.A;
- Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e mbajtur më: 25.06.2024 ka miratuar Rregulloren mbi Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të KRU "Hidromorava" Sh.A.

3. KOMISIONI I AUDITIMIT

Komisioni i Auditimit gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024 ka mbajtur një /1/ mbledhje të rregullt dhe dy /2/ mbledhje të jashtëzakonshme dhe bazuar në procesverbalet të dt. 11.05.2024, 15.05.2024, 07.06.2024, ka marrë këto vendime:

3.1. Vendimet e Komisionit të Auditimit

- Komisioni i Auditimit, në mbledhjen e parë të jashtëzakonshme të mbajtur më datë: 11.05.2024, ka miratuar Raportin e Auditimit të Jashtëm të pasqyrave financiare për vitin 2023;
- Komisioni i Auditimit, në mbledhjen katërt (IV-të) të rregullt të mbajtur më datë: 15.05.2024, ka miratuar "Deklaratën për kompensimin për Drejtorët e Bordit dhe Zyrtarëve të Lartë për vitin 2024";
- Komisioni i Auditimit, në mbledhjen e dytë të jashtëzakonshme të mbajtur më datë: 07.06.2024, ka aprovuar dorëhqejën e ZLAB të KRU "Hidromorava" Sh.A. dhe ka vendosur të shpallë konkursin e jashtëm lidhur me pozitën: Zyrtar i Auditimit të Brendshëm.

4. ZYRA E SEKRETARES

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, janë protokolluar dhe arkivuar 435 akte nga shërbimi juridik. Gjatë këtij tremujori janë mbajtur gjithsej nëntë /9/ mbledhje të rregullta të Menaxhmentit të Ndërmarrjes. Gjithashtu, janë nxjerrë akte si: urdhëresa, lajmërimi, njoftime, vërtetime të ndryshme konsumatorëve dhe punëtorëve të Ndërmarrjes për nevoja personale, vendime për pushime vjetore, autorizime, kërkesa, përgjigje në kërkesa dhe ankesa të ndryshme. Është iniciuar një /1/ kallëzim penal ndaj konsumatorit të pandërgjegjshëm dhe janë pranuar 12 ankesa me shkrim, me ç'rast Komisioni për shqyrtimin e ankesave i ka shqyrtuar të gjitha.

4.1. Struktura e të punësuarve

KRU "Hidromorava" Sh.A Gjilan, ka operuar me gjithsej 166 të punësuar.

Tabela 3. Numri i të punësuarve në njësitë punuese për periudhën TM2/2024

Numri i të punësuarve në njësitë e caktuara punuese	Gjilan	Kamenicë	Viti
	126	18	22

Tabela 4. Struktura gjinore e të punësuarve për periudhën TM2/2024

Numri i të punësuarve sipas përkatësisë gjinore	Numri i të punësuarve (meshkuj)	Numri i të punësuarve (femra)	Numri total i të punësuarve
	141	25	166

4.2. Çështjet gjyqësore

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, KRU “Hidromorava”- SH.A. në Gjilan, nga ana e gjykatave kompetente ka pranuar lëndët e paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5. Lëndët e pranuar nga Gjykatat kompetente gjatë periudhës TM2/2024

Lëndët e pranuar nga gjykatat kompetente			
Datë	Institucioni	Nr. Aktvendimit	Arsyetimi
02.04.2024	Gjykata e Apelit e Kosovës, Prishtinë	CAP.nr.69/23 i datës 21.03.2024	Aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit KRU “Hidromorava”- SH.A. aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan CPK. nr.194/22 i dt. 07.12.2022, prishet dhe çështja i kthehet të njejtës gjykatë në rivendosje, për shkak borxhit të debitorit Mexhid Abazi nga fshati Përlepticë, Komuna Gjilan në vlerë prej: 1,120.00€.
17.04.2024	Gjykata e Apelit e Kosovës, Prishtinë	Ac.nr.5912/2022 i dt. 29.03.2024	Refuzohet e pathemeltë ankesa e debitorit Sami Bajraliu nga Gjilani, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK. nr.175/21 i dt. 12.07.2022, vërtetohet borxhi në vlerë prej: 2,087.00€.
03.05.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm	C.nr. 91/2023 i dt. 23.04.2024	Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.91/2023 të dt. 23.04.2024, është refuzuar në terësi si e pabazuar padia e paditësit Muhamed Suliqi nga Gjilani, për shkak anulimit të vendimit për ndërprerjen e mardhënies së punës dhe kompensimin e të ardhurave personale.
03.05.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm	CPK.nr.97/2023 i dt. 30.04.2024	Është refuzuar në terësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Fatmir Bajra nga Gjilani, ndërsa urdhëri përmbarimor P.nr. 385/23 i dt. 05.09.2023 mbetet në fuqi, në vlerë prej: 1,775.23€.
10.05.2024	Gjykata e Apelit e Kosovës, Prishtinë	Ac.nr. 5081/21 i dt.22.04.2024	Refuzohet e pathemeltë ankesa e paditësit Sadik Kosumi nga Gjilani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.448/2021 i

			dt. 03.06.2021, vërtetohet për shkak kompensimit të pagave jubilarë.
10.05.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm	CPK.nr.38/23 i dt. 02.05.2024	Është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Nuhi Klaiqi nga Gjilani, ndërsa mbetet në fuqi urdhëri përmbartimor P.nr. 36/18 i dt. 09.01.2018, në vlerë prej: 690.20 €.
10.05.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm	C.nr.3376/2023 i dt. 24.04.2024	Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr. 3376/2023 i dt. 24.04.2024, është refuzuar në terësi si e pabazuar padia e paditësit Berat Dërmaku nga f.Shipasnicë e Epërme, Komuna e Kamenicës, për shkak anulimit të vendimit nr.2262 të dt. 14.12.2023.
14.05.2024	Gjykata Themelore në Gjilan- Departamenti i përgjithshëm	CPK.nr. 23/2024 i dt. 10.05.2024	Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, CPK. nr.23/2024 të dt. 10.05.2024, është aprovuar pjesërisht prapësimi i debitorit Mexhid Abazi nga fshati Përlepnicë, Komuna Gjilan, me të cilën nga borxhi total në vlerë prej: 1,120.00€, të njejtit i është parashkruar borxhi në vlerë prej: 983.52€, ndërsa borxhi për pagesë ndaj kreditorit mbetet në vlerë prej: 136.48€. Kundër këtij aktvendimi kreditori ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
14.05.2024	Gjykata Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm	CPK.nr. 59/2023 i dt. 30.04.2024	Është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Yll Isufi nga Gjilani, ndërsa mbetet në fuqi urdhëri përmbartimor P.nr. 58/23 i dt. 30.06.2023, në vlerë prej: 742.87€.
17.05.2024	Dhoma e posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, Prishtinë	C-IV-14-0521 i dt. 16.05.2024	Me Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, C-IV-14-0521 të dt. 16.05.2024, është aprovuar si e bazuar kërkesa për rishikim të Aktvendimit të Autoritetit të likuidimit të AKP-së e KRU “Hidromorava” Sh.A., duke e obliguar autoritetin e likuidimit që në emër të kompensimit të faturave të papaguara të ujit parashtruesit të kërkesës ti paguhet shuma prej : 11,064.62€.

17.05.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i përgjithshëm	CPK.nr.62/2023 i dt. 13.05.2024	Është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Mustafë Rexhepi nga Gjilani, ndërsa mbetet në fuqi urdhëri përmbarimor P.nr. 290/23 i dt. 13.05.2024, në vlerë prej: 3,107.90€.
17.05.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i përgjithshëm	CPK. nr.60/2023 i dt. 13.05.2024	Është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Lulzim Rexhepi nga Gjilani, ndërsa mbetet në fuqi urdhëri përmbarimor P.nr. 286/23 i dt. 30.06.2023 , për shkak borxhit të debitorit në vlerë prej: 2,443.90€.
20.06.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i përgjithshëm	CPK. nr. 71/2023 i dt.14.06.2024	Është refuzuar si i pa bazuar prapësimi i debitorit Afrim Jetishi nga Gjilani, ndërsa mbetet në fuqi urdhëri përmbarimor P.nr. 258/22 i dt. 14.06.2023, në vlerë prej:1,134.95€.
20.06.2024	Gjykata e Apelit e Kosovës, Prishtinë	Ac.nr.1494/2022 i dt. 31.05.2024	Aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit KRU “Hidromorava” Sh.A. aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, PPP. nr.7/2021 i dt. 16.02.2022, prishet dhe çështja i kthehet të njejtës gjykatë në rivendosje, për shkak borxhit të debitorit Isa Haxhiu nga Vitia, në vlerë prej: 1,176.36€.
26.06.2024	Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë	PPP. nr.40/2021 të dt. 13.06.2024	Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, PPP. nr.40/2021 të dt. 13.06.2024, është aprovuar pjesërisht prapësimi i debitorit Srdjan Stamenkoviq nga Kamenica, me të cilën nga borxhi total në vlerë prej: 1,119.38€, të njejtit i është parashkruar borxhi në vlerë prej: 927.03 €, ndërsa borxhi për pagesë ndaj kreditorit mbetet në vlerë prej: 192.35 €, kundër këtij aktvendimi kreditori ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

5. ZYRTARJA E LARTË FINANCIARE

5.1. Aktivitetet kryesore


Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, janë zhvilluar aktivitetet e zakonshme sa i përket departamentit financiar si: kontrollimi dhe barazimi i llogarive të pagueshme dhe llogarive të arkëtueshme, raportet ditore nga shërbimi i arkave, barazimi i gjendjeve bankare, kontimet, shkarkimet nga pagesat të cilat transferohen nga insitucionet mikro financiare dhe bankare, kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre, përgatitjet e pagave, plotësimi i librave të blerjes dhe shitjes sipas formës së kërkuar nga ATK-ja për muajin përkatës dhe tremujore, deklarimi i tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave sipas ligjit në fuqi.

5.2. Shqyrtimi i performances operative dhe financiare

5.2.1. Prodhimi i ujit në m³

Prodhimi i ujit në m³ për TM2/2024 në krahasim me TM2/2023 ka rritje për 10.81 %, ndërsa sa i përket arritjes së caktut të planifikuar është tejkaluar për 12.17 %.


Tabela 6. Paraqitja grafike e prodhimit të ujit në m³



5.2.2. Faturimi i ujit në m³

Faturimi i ujit në m³ për TM2/ 2024 në krahasim me TM2/2023 ka shënuar rritje për 14.03%, ndërsa sa i përket arritjes së caktut të planifikuar, është nën plan për 12.64%.


Tabela 7. Paraqitja grafike e faturimit të ujit në m³



5.2.3. Faturimi i ujit në euro (€)

Faturimi i ujit në euro (€) në TM2/2024 në krahasim me TM2/2023 ka rritje 13.30 %, ndërsa sa i përket realizimit të planit, ai është arritur në masën 91.07 %.


Tabela 8. Paraqitja grafike e faturimit në euro (€)



5.2.4. Arkëtimi i ujit

Arkëtimi i ujit për TM2/2024 në krahasim me TM2/2023 ka shënuar rritje për 4.69%. Arkëtimi nga borxhet e vjetra ka ndikuar në rritje të normës së arkëtimit, ndërsa sa i përket realizimit të planit, është realizuar 92.56 %.


Tabela 9. Paraqitja grafike e arkëtimit të ujit



5.2.4.1. Përqindja e arkëtimit

Përqindja e arkëtimit nga faturimi për TM2/2024 në krahasim me TM2/2023 ka rrënie për 7.82%, ndërsa sa i përket realizimit të planifikuar ka arritur tejkalim për 1.73 %.

Tabela 10. Paraqitja grafike e përqindjes së arkëtimit



5.2.5. Shpenzimet

Shpenzimet në TM2/2024 në krahasim me TM2/2023, kanë shënuar rritje për 0.81 %. Arsyeja e rritjes është për shkak të rritjes së stafit, shpenzimeve të energjisë etj.

Tabela 11. Paraqitja grafike e shpenzimeve në €



Tabela 12. Raporti i performancës operative dhe financiare për regjion TM2/2024 dhe TM2/2023 dhe plani TM2/2024

	Indikatorët – Regjion	TM2 /2024	TM2 /2023	Realizimi 2024/2023 (në %)	Trendi 2024/2023	Plani TM2 /2024	Realizimi i planit (në %)	Trendi 2024 me Planin
1	Prodhimi i ujit (m3)	2,299,572	2,075,155	110.81	poz	2,050,000	112.17	poz
2	Faturimi (m3)	1,078,731	946,002	114.03	poz	1,234,819	87.36	neg
3	Uji i pafaturar (m3)	1,220,841	1,129,153	108.12	neg	815,181	66.77	neg
4	Faturimi (€)	620,670	547,797	113.30	poz	681,530	91.07	neg
5	Arkëtimi (€)	590,171	563,739	104.69	poz	637,629	92.56	neg
6	Shkalla e arkëimit (%)	95.09	102.91	92.40	neg	93.56	101.63	poz
7	Shpenzimet (€)	524,731	523,495	100.81	neg	547,180	104.28	poz
8	Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	42,667	40,491	105.37	poz	41,843	101.97	poz
9	Numri i konsumtorëve me ujëmatës (nr)	38,649	36,606	105.58	poz	38,670	99.95	neg
10	Numri i konumatorëve me konsum zero (nr)	19,361	18,206	106.34	neg	14,000	72.31	neg
11	Konsumatorë të rinj (nr)	395	352	112.22	poz	300	131.67	poz
12	Numri i konsumatorëve aktiv (nr)	38,814	36,807	105.45	poz	38,745	100.18	poz
13	Numri i konsumatorëve pa matje (nr)	165	201	82.09	poz	80	48.48	neg
14	Faturimi i ujit me ujëmatës (m3)	1,045,631	943,821	110.79	poz	1,232,473	84.84	neg
15	Proporcioni i konsumatorë me ujëmatës (%)	99.57	99.45	100.12	poz	99.81	99.77	neg

16	UPF në (%)	53.09	54.41	97.57	poz	39.76	74.90	neg
17	Norma e mbulimit operativ	1.18	1.05	112.39	poz	1.17	101.50	neg
18	Fitimi /humbja operative	95,939	27,274	351.76	poz	134,350	71.41	neg
19	Kostoja për Njësi (€/m ³)	0.23	0.25	90.97	poz	0.27	116.97	poz
20	Efikasiteti i stafit (*000 kons)	4.35	4.51	96.45	poz	4.47	102.76	poz

Tabela 13. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë Operative të Gjilanit TM2/2024 dhe krahasimi me TM2/2023

	Indikatorët – Gjilan	TM2 /2024	TM2 /2023	Realizimi 2024/2023 (në %)	Trendi 2024/2023
1	Prodhimi i ujit (m3)	1,700,885	1,628,212	104.46	poz
2	Faturimi (m3)	844,669	747,714	112.97	poz
3	Uji i pafaturar (m3)	856,216	880,498	97.24	poz
4	Faturimi (€)	492,919	436,608	112.90	poz
5	Arkëtimi (€)	496,741	467,620	106.23	poz
6	Shkalla e arkëtitimit (%)	100.78	107.10	94.09	neg
7	Shpenzimet (€)	402,071	409,190	98.26	poz
8	Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	32,638	31,127	104.85	poz
9	Numri i konsumatorëve me ujëmatës (nr)	30,386	28,974	104.87	poz
10	Numri i konsumatorëve me konsum zero (nr)	14,846	14,276	103.99	poz
11	Konsumatorë të rinj (nr)	263	271	97.05	neg
12	Numri i konsumatorëve aktiv (nr)	30,445	29,088	104.67	poz
13	Numri i konsumatorëve pa matje (nr)	59	114	51.75	poz
14	Faturimi i ujit me ujëmatës (m3)	836,785	747,269	111.98	poz
15	Proporcioni i konsumatorë me ujëmatës (%)	99.81	99.61	100.20	poz
16	UPF në (%)	50.34%	54.08%	93.08	poz
17	Norma e mbulimit operativ	1.23	1.07	114.90	poz
18	Fitimi /humbja operative	90,848	27,418	331.34	poz
19	Kostoja për Njësi (€/m ³)	0.24	0.25	94.06	poz
20	Efikasiteti i stafit (*000 kons)	4.14	4.40	94.06	poz

Tabela 14. Raporti i performancës operative dhe financiar për Njësinë Operative të Kamenicës TM2/2024 dhe krahasimi me TM2 /2023

	Indikatorët – Kamenicë	TM2/2024	TM2/2023	Realizimi 2024/2023 (në %)	Trendi 2024/2023
1	Prodhimi i ujit (m3)	206,587	174,033	118.71	poz
2	Faturimi (m3)	112,210	103,541	108.37	poz
3	Uji i pafaturar (m3)	94,377	70,492	133.88	neg
4	Faturimi (€)	60,530	56,950	106.29	poz
5	Arkëtimi (€)	50,611	53,541	94.53	neg
6	Shkalla e arkëtimit (%)	83.61%	94.01%	88.94	neg
7	Shpenzimet (€)	67,981	57,946	117.32	neg
8	Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	5,371	5,293	101.47	poz
9	Numri i konsumtorëve me ujëmatës (nr)	4,265	4,204	101.45	poz
10	Numri i konsumtorëve me konsum zero (nr)	2,132	2,190	97.35	poz
11	Konsumatorë të rinj (nr)	11	7	157.14	poz
12	Numri i konsumtorëve aktiv (nr)	4,265	4,205	101.43	poz
13	Numri i konsumtorëve pa matje (nr)	0	0	100.00	poz
14	Faturimi i ujit me ujëmatës (m3)	112,210	103,541	108.37	poz
15	Proporcioni i konsumatorë me ujëmatës (%)	100.00	99.98	100.02	poz
16	UPF në (%)	45.68	40.50	112.79	neg
17	Norma e mbulimit operativ	0.89	0.98	90.60	neg
18	Fitimi /humbja operative	-7,451.00	-996.00	748.09	neg
19	Kostoja për Njësi (€/m ³)	0.33	0.33	100	poz
20	Efikasiteti i stafit ('000 kons)	4.22	4.52	93.40	poz

Tabela 15. Raporti i performancës operative dhe financiare për Njësinë Operative në Vitisë për TM2/2024, krahasimi me TM2/2023

	Indikatorët – Viti	TM2 /2024	TM2 /2023	Realizimi 2024/2023 (në %)	Trendi 2024/2023
1	Prodhimi i ujit (m3)	392,100	272,910	143.67	poz
2	Faturimi (m3)	121,852	94,748	128.61	poz
3	Uji i pafaturar (m3)	270,248	178,162	151.69	neg
4	Faturimi (€)	67,221	54,239	123.93	poz
5	Arkëtimi (€)	42,819	42,578	100.57	poz
6	Shkalla e arkëtitimit (%)	63.70	78.50	81.15	neg
7	Shpenzimet (€)	54,686	53,387	102.43	neg
8	Numri i konsumtorëve të regjistruar (total)	4,658	4,071	114.42	poz
9	Numri i konsumtorëve me ujëmatës (nr)	3,998	3,428	116.63	poz
10	Numri i konsumatorëve me konsum zero (nr)	2,383	1,740	136.95	neg
11	Konsumatorë të rinj (nr)	121	74	163.51	poz
12	Numri i konsumatorëve aktiv (nr)	4,104	3,514	116.79	poz
13	Numri i konsumatorëve pa matje (nr)	106	86	123.26	neg
14	Faturimi i ujit me ujëmatës (m ³)	96,636	93,012	103.90	poz
15	Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	97.42	97.55	99.86	neg
16	UPF në (%)	68.92	65.28	105.58	neg
17	Norma e Mbulimit operativ	1.23	1.02	120.99	poz
18	Fitimi / humbja operative	12,535	852	1,471.24	poz
19	Kostoja për Njësi (€/m3)	0.14	0.20	71.30	poz
20	Efikasiteti i stafit (*000 kons)	5.36	5.40	99.27	poz

Tabela 16. Treguesit – të hyrat dhe shpenzimet operative për TM2/2024 dhe krahasimi me TM2/2023

	TM2 2024	TM2 2023
Të hyrat nga shitja e ujit	610,408.00	543,722.00
Të hyrat nga shërbimet	17,839.00	18,642.00
Të hyrat nga grandet	108,780.00	101,920.00
Të hyrat totale	737,027.00	664,284.00
Shpenzimet e personelit ¹	(375,424.00)	(354,371.00)
Shpenzimet e energjisë ²	(68,664.00)	(61,586.00)
Shpenzimet për derivate	(9,252.00)	(8,380.00)
Shpenzimet për kimikate	(9,467.00)	(17,059.00)
Shpenzimet për analiza të ujit	(5,506.00)	(5,080.00)
Ngarkesa për shërbime të ARRU-së	(4,686.00)	(6,053.00)
Ngarkesa për shërbime nga MMPH	(892.00)	0.00
Shpenzimet e qirasë	(3,503.00)	(5,671.00)
Shpenzimet e materialit të kontraktuar dhe konsumueshme	(16,375.00)	(1,484.00)
Ngarkesa për shërbime të SHUKOŞ-it	(2,350.00)	(1,760.00)
Shpenzime të tjera direkte	(2,012.00)	(25,056.00)
Shpenzimet për mirëmbajtje	(19,135.00)	(19,421.00)
Shpenzimet e reprezentacionit	(1,114.00)	(1,174.00)
Shpenzimet për telefon dhe internet	(3,633.00)	(3,309.00)
Shpenzimet e provizionit/përmbaruesit	(908.00)	(7,899.00)
Shpenzimet e materialit administrativ	(1,810.00)	(5,192.00)
Shpenzimet totale operative	524,731.00	523,495.00

¹ Rritja e shpenzimeve të pagave gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 është rezultat i shtimit të numrit të të punësuarëve.

